

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Modul 1 - Lënda
Parakualifikuese**

M1

Nr.

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Udhëzime/Instructions:

1. MOS E HAPNI DERISA T'JU LEJOHET PREJ
MBIKËQYRËSIT
Do Not Open Until Your invigilator Allows You to Do So.
2. ËSHTË E DETYRUESHME PËRGJIGJA E GJITHA PYETJEVE
All Questions Are Mandatory
3. KOHA E LEJUAR ËSHTË 3 ORË
Time Allowed is 3 Hours
4. EMRI JUAJ NUK DUHET TË PARAQITET NË ASNJË FLETË TË
KËTIJ PROVIMI.
Your name should appear nowhere in this test.

Data 14.04.2018

CONTENT / PËRMBAJTJA

Pjesa	Maksimumi i Dhënë	-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK- PIKËT E DHËNA
Pjesa 1	25	
Pjesa 2	25	
Pjesa 3	25	
Pjesa 4	25	
Total	100	

1. Çfarë efekti ka inkasimi i një llogarie të arkëtueshme në total pasuritë?

- A. Total pasuritë mbesin të pandryshuara.
- B. Total pasuritë rriten.
- C. Total pasuritë zvogëlohen.
- D. Të gjitha të mësipërmet.

(1 pikë)

2. Cila nga deklaratat e mëposhtme është konsistente me bazën akruale të kontabilitetit?

- A. Të hyrat regjistrohen kur pranohet paraja.
- B. Shpenzimet regjistrohen kur paraja paguhet.
- C. Shpenzimet regjistrohen në periudhë të ndryshme nga të hyrat përkatëse.
- D. Të hyrat regjistrohen kur fitohen dhe shpenzimet kur ndodhin.

(1 pikë)

3. Bilanci i Gjendjes i Rona L.t.d. përfshin kostot personale të banimit të pronarit. Cili nga parimet e mëposhtme nuk është respektuar?

- A. Parimi i entitetit të biznesit.
- B. Parimi akrual.
- C. Parimi i vazhdimësisë.
- D. Parimi i njësisë monetare të qëndrueshme.

(1 pikë)

4. Cili grup i koeficienteve matë aftësin e biznesit për mbulimin e obligimeve afatëshkurtra?

- A. Koeficientet e likuiditetit
- B. Koeficientet e detyrimeve
- C. Koeficientet e mbulimit
- D. Koeficientet e fitimit

(1 pikë)

5. Krenxa's Co. ka koeficientin e detyrimeve ndaj pasurive totale 40%. Sa është koeficienti i detyrimeve ndaj ekuitetit?

- A. 0.2
- B. 0.77
- C. 0.667
- D. 0.333

(1 pikë)

6. Fitimi neto rezulton kur:

- A. Investimet i tejkalojnë tërheqjet.
- B. Të hyrat tejkalojnë tërheqjet.
- C. Të hyrat tejkalojnë shpenzimet.
- D. Shpenzimet tejkalojnë të hyrat.

(1 pikë)

7. Cila nga deklaratat në vijim është e pasaktë?
- A. Të hyrat e rrisin ekuitetin e pronarit.
 - B. Të hyrat normalisht kanë saldo kreditore.
 - C. Të hyrat janë faktor pozitiv në llogaritjen e fitimit neto.
 - D. Të hyrat janë investim nga pronarët.
- (1 pikë)
8. Shitjet neto janë të barabarta me shitjet minus:
- A. Kosto e mallit të shitur.
 - B. Shpenzimet e shitjes.
 - C. Tatimi në shitje.
 - D. Kthimet dhe lejet nga shitja.
- (1 pikë)
9. Shpenzimet e llogarisë së telefonit e cila përbëhet nga pjesa bazë në shumë prej €200, plus ngarkesave për bisedat në distanca të largëta, duhet të klasifikohen si:
- A. Shpenzime variabile
 - B. Kosto fikse të zotuar
 - C. Kosto fikse për veprime të lira
 - D. Kosto të përziera
- (1 pikë)
10. Cila nga metodat e mëposhtme të vlerësimit të vendimeve për investime kapitale mbështetët në vlerësimin se rrjedhjet e parasë janë të njëjta përgjatë jetës së një investimi?
- A. Norma e brendshme e kthimit
 - B. Metoda e kthimit (shpagesës)
 - C. Vlera neto e tanishme
 - D. Norma e pakorrigjuar e kthimit (shpagimit)
- (1 pikë)
11. Diferenca kryesore në mes të kontabilitetit menaxherial dhe kontabilitetit financiar është:
- A. Që përderi sa kontabiliteti menaxherial jep informata më tepër për shfrytëzuesit e mbrenshëm, kontabiliteti financiar është i fokusuar në nxjerrjen e informatave që shfrytëzohen nga shfrytëzuesit e jashtëm të organizatës.
 - B. Që përderi sa kontabiliteti menaxherial është më i vështir, kontabiliteti financiar është më i lehtë.
 - C. Që përderi sa kontabiliteti menaxherial është më i aplikueshëm, kontabiliteti financiar është më pak i aplikueshëm.
 - D. Që përderi sa kontabiliteti menaxherial është i rregulluar nga rregullat dhe ligjet qeveritare, kontabiliteti financiar aplikon dhe rregullohet nga Standardet Internacionale të Kontabilitetit (SIK).

(1 pikë)

12. Tekë një firmë prodhuese Kosto e Mallrave të Shitjes në pasqyrën financiare duhet të përfshijë

- A. Stoqet e produkteve të gatshme në fillim
- B. Koston e mallrave të prodhuar
- C. Stoqet e produkteve të gatshme në fund
- D. Të gjitha më lart.

(1 pikë)

13. Nëse volumi i prodhimit zvogëlohet,

- A. Shpenzimet variabile për njësi zvogëlohen.
- B. Shpenzimet fikse në total zvogëlohen.
- C. Shpenzimet variabile në total mbesin të njëjta.
- D. Shpenzimet fikse për njësi rriten.

(1 pikë)

14. Në formën e grafikonit, pika e rentabilitetit paraqet interaksionin e

- A. Të hyrave totale dhe linjës së shpenzimeve variabile.
- B. Shpenzimeve totale dhe bushtit vertikal.
- C. Shpenzimeve variabile dhe linjës së shpenzimeve fikse.
- D. Shpenzimeve totale dhe linjës totale të të hyrave.

(1 pikë)

15. Cila nga të më poshtëmet mund të konsiderohet si shpenzim i produktit?

- A. Rroga e menaxherit financiar.
- B. Zhvlersimi i depos që shfrytëzohet për ruajtjen e mallrave të gatëshëm.
- C. Sigurimi i ndërtesës së fabrikës.
- D. Shpenzimi i interesit për huan që është përdorur për blerjen e makinerive.

(1 pikë)

16. Cila nga aktivitetet e më poshtëme nuk shton vlerën e produktit?

- A. Shërbimi
- B. finalizimi
- C. paketimi
- D. montimi

(1 pikë)

17. Cikloni Inc. në pasqyrën e të ardhurave të këtij viti i raporton informatat si në vijim:

Shitjet	€450,000
Përqindja e fitimit bruto	30%
Norma e tatimit në të ardhura	35%
Shpenzimet e shitjes	€55,000
Shpenzimet administrative	€40,000

Cilën shumë të fitimit neto ka raportuar Cikloni për vitin aktual?

- A. €14,000.
- B. €26,000.**
- C. €40,000.
- D. €54,500.

(2 pikë)

18. Nëse çmimi i shitjes për një produkt është 6Euro për njësi, margjina variabile 2 Euro për njësi, dhe shpenzimet fikse janë 45,000Euro, sa është pika e rentabilitetit në njësi ?

- A. 7,500
- B. 22,500**
- C. 45,000
- D. 11,250

(2 pikë)

19. Sa njësi të produktit duhet të shiten që të arrihet fitimi prej €10,000, duke supozuar se kostoja variabile është €7 për njësi, kostot totale fikse janë €800, dhe çmimi i shitjes për njësi është €10?

- A. 4,800 njësi
- B. 4,400 njësi
- C. 4,000 njësi
- D. 3,600 njësi**

(2 pikë)

20. Llogaritë e librit kryesor të AS Express me 31 dhjetor 2015, përbëhen nga saldot në vijim:

Llogaritë e pagueshme	3,941	Sigurimi i parapaguar	411
Llogaritë e arkëtueshme	7,396	Shpenzimet e riparimit	961
Paraja	2,033	Shpenzimet e rrogave	24,780
Pajisjet	44,980	Rrogat e pagueshme	815
Shpenzimet e karburanteve	288	Të hyrat nga shërbimet	27,600
Shpenzimet e sigurimit	1,644	Furnizimet	492
Shpenzimet e interesit	957	Kapitali i AS	44,636
Investimet afatgjata	2,650	Tërheqjet e AS	9,000
Dëftesa e pagueshme	18,450	Të hyrat e shtyera	150

Kërkohet: Përgatitni bilancin e gjendjes me 31 dhjetor 2015 nese humbja e vitit eshte 1,030.

(3 pikë)

AS Express	
Bilanci i gjendjes me 31 dhjetor 2015	
PASURIA	
Paraja	2,033
Llogaritë e arkëtueshme	7,396
Furnizimet	492
Sigurimi i parapaguar	411
Pajisjet	44,980
Investimet afatgjata	2,650
Gjithsej pasuri	57,962
DETYRIMET DHE EKUITETI I PRONARIT	
Detyrimet	
Dëftesa e pagueshme	18,450
Llogaria e pagueshme	3,941
Rrogat e pagueshme	815
Të hyrat e shtyera	150
Gjithsej detyrimet	23,356
Ekuiteti i pronarit	
Kapitali i AS	34,606
Gjithsej detyrimet dhe ekuiteti i pronarit	57,962

1. Bazuar ne Ligjin Për Shoqëritë Tregtare: Shoqëria tregtare mund të themelohet dhe regjistrohet për çfarëdo qëllimi të ligjshëm dhe mund të kryejë çfarëdo veprimtarie të ligjshme dhe te pa ligjshme.

E saktë

E pasaktë

2. Sipas Ligjit Për Shoqëritë Tregtare një pronar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar nuk është përgjegjës për borxhet ose detyrimet e shoqërisë vetëm për arsye se është pronar.

E saktë

E pasaktë

3. Sipas Ligjit Nr. 04/L-014 "Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim", te gjitha bizneset detyrohen ti nënshtrohen audtitimit nga firmat audituese te licencuar mbi kriteret e këtij ligji.

E saktë

E pasaktë

4. Sipas Ligjit Nr. 04/L-014 "Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim", Shoqëritë tregtare janë të obliguara të ruajnë pasqyrat financiare bashkë me librat ndihmëse në afat prej dhjetë (10) vitesh.

E saktë

E pasaktë

5. Bazuar ne sistemin tatimor te Kosoves, ekzistojne keto tri lloje kryesore te tatimit te cilat nje person juridik apo individ mund ti paguaje:

a) Tatimi ne fitim, Tatimi per perdorim te automjeteve dhe Tatimi per derivate;

b) Tatimi ne te ardhurat e korporate, Tatimi ne te ardhura personale dhe TVSH.

6. Sipas Ligjit Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, Librat dhe regjistrimet minimale qe duhet mbaj një biznes me qarkullim vjetor bruto deri ne 50,000, apo me pak janë: libri i blerjes; libri i shitjes; libri i arkës.

E saktë

E pasaktë

7. Sipas Ligjit Nr. 03/L-222 Për Administratën Tatimore dhe Procedurat renditja e pagesave tek tatimpaguesit nga shpenzimet e mbledhjes e deri te interesi bëhet sipas vullnetit te vet tatimpaguesit:

E saktë

E pasaktë

8. Bazuar ne Ligjin Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, një tatimpagues mundet të dorëzojë një ndryshim deklarate tatimore nëse ai ose ajo më vonë zbulon gabim në deklaratën tatimore të cilën e ka dorëzuar tashmë. Afati për të dorëzuar një ndryshim deklarate është jo më vonë se katër (4) vjet pas datës obligative kur deklarata është dorëzuar fillimisht.

E saktë

E pasaktë

9. Sipas Ligjit Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, çdo shumë e tatimit e paguar mbi shumën e detyrimit tatimor, me kërkesën e tatimpaguesit do të kreditohet ndaj detyrimit aktual të tatimpaguesit për çdo detyrim tjetër tatimor dhe kontribute pensionale.

E saktë

E pasaktë

10. Sipas ligjit nr. 03/L-162 Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, një organizatë e regjistruar si organizatë jo qeveritare sipas Legjislacionit që rregullon regjistrimin dhe funksionimin e OJQ-ve, në Kosovës do të konsiderohet tatimpagues.

E saktë

E pasaktë

11. Sipas ligjit nr. 05/L-029 Për Tatimin ne te Ardhurat e Korporatave, çdo humbje nga shitja apo këmbimi i pasurisë në mes të personave të lidhur konsiderohet shpenzim i pa zbritshëm.

E saktë

E pasaktë

12. Sipas ligjit nr. 05/L-029 Për Tatimin ne te Ardhurat e Korporatave, blerja e një pasurie për çmimin prej 1,000 euro ose me pake do të lejohet si shpenzim rrjedhës.

E saktë

E pasaktë

13. Sipas Ligjit te nr . 03/L-162 Për Tatimin ne te Ardhurat e Korporatave shuma e humbjes tatimore e përcaktuar sipas këtij neni, mund të bartet deri në gjashtë (6) vite të njëpasnjëshme tatimore dhe është e disponueshme si zbritje ndaj çfarëdo të ardhure për ato vite.

E saktë

E pasaktë

14. Sipas ligjit nr.03/L-161 për Tatimin në të Ardhurat Personale, Tatimpaguesit janë:
Personat fizikë rezident dhe jo rezident; Ndërmarrja personale afariste dhe Ortakëritë.

E saktë

E pasaktë

15. Sipas Ligjin nr .05/L-028 Për Tatimin ne te Ardhurat Personale, fitimet kapitale që rezultojnë nga shitjet e pasurive kapitale, duke përfshirë pasurinë e tundshme, të patundshme dhe letrat me vlerë nuk konsiderohen te ardhurat te tatueshme.

E saktë

E pasaktë

16. Sipas Ligjin nr .05/L-028 Për Tatimin ne te Ardhurat Personale, edhe pagat e personave me nevoja të veçanta, siç parashihet me ligjet përkatëse për këto kategori janë te ardhura te tatueshme.

E saktë

E pasaktë

17. Sipas ligjit te Tvsh, çdo person është i obliguar që të regjistrohet për Tvsh nga momenti i kalimit të qarkullimit prej tridhjetëmijë Euro (30.000€), brenda vitit kalendarik dhe duhet të njoftojë ATK-në brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve kalendarike prej momentit kur ka lindur obligimi për regjistrim.

E saktë

E pasaktë

18. Detyrimi për ngarkesë me TVSH për mallra dhe shërbime lind varësisht se cili nga tri momentet që ndodh i pari: pranimi i parasë, furnizim i mallit apo shërbimit dhe lëshimi i faturës në lidhje me furnizimin e mallit apo shërbimit.

E saktë

E pasaktë

19. Sipas ligjit të TVSh-se, nëse personi brenda vitit kalendarik tejkalon qarkullimin prej pesëdhjetëmijë euro (50.000€) kërkohet që të regjistrohet për TVSH.

E saktë

E pasaktë

20. Sipas ligjit të TVSH-se, TVSH-ja ngarkohet sipas normës standarde 16% dhe normës së reduktuar 8%.

E saktë

E pasaktë

21. Sipas ligjit të Tvsh-së bizneset e huaja duhet të regjistrohen në regjistrin e detyrueshëm të Tvsh-së nga momenti i fillimit të aktivitetit të tyre në territorin e Kosovës.

E saktë

E pasaktë

22. Sipas Ligjit mbi Pensionet në Kosovë, për të gjitha kategoritë e personave të vetëpunësuar, minimumi i tremujorit të kontributeve do të jetë tridhjetë përqind (30%) të pagesës Minimale.

E saktë

E pasaktë

23. Sipas Ligji të Punës për punët gjatë natës pagesa shtese behet 30% me e larte se ne orët e zakonshme të punës.

E saktë

E pasaktë

24. Sipas Ligjit mbi Pensionet në Kosovë, maksimumi i lejuar për pagesën e kontributit pensional punëdhënës i punësuar është 1/3 e pagës.

E saktë

E pasaktë

25. Sipas Ligjit të Punës, nuk konsiderohet diskriminim, çdo dallim përjashtim ose dhënie e përparësisë, përkitazi me ndonjë vend të caktuar pune, në bazë të kriterëve të caktuara që kërkohen për atë vend pune.

E saktë

E pasaktë

1. Cilat janë llojet e gjera të vendimeve që kanë të bëjnë me menaxhimin financiar(2)?
 - A. Vendimet mbi pasurinë
 - B. Vendimet mbi investimet
 - C. Vendimet mbi financimin
 - D. Vendimet mbi të hyrat dhe terheqjet

(2 pikë)

2. Sipas teorive të financave të kompanive, mbi cilat objektiva kryesore financiare supozohet se operojnë bizneset(2)?
 - A. Zvogëlimi i punësimit
 - B. Maksimizimi i fitimit
 - C. Përgaditja e sakte e pasqyrave financiare
 - D. Pjesa e tregut

(2 pikë)

3. Ndermjetesit financiarë janë persona apo institucione të cilët lidhin ata që kanë tepricë të fondeve me ata të cilët kërkojnë fonde shtesë dhe ata janë (2):
 - A. Bankat komerciale
 - B. Institucionet qeveritare komunale
 - C. Institucionet e kursim – kredive
 - D. Dogana dhe ATK

(2 pikë)

4. Dy objektivat kryesore të menaxhimit të kapitalit qarkullues janë(2):
 - A. Shitja e produkteve dhe shërbimeve me kohë për klientet
 - B. Sigurimi i parase se gatshme për të blerë mjete themelore
 - C. Berja e sigurt që biznesi ka burime të mjaftueshme likuide që të vazhdojë afarizmin
 - D. Rritja e fitim-prurjes së biznesit

(2 pikë)

5. Cila nga të mëposhtmet paraqet përkufizimin e koeficientit qarkullues (korrent) (1)?
 - A. Koeficienti i pasurive qarkulluese mbi detyrimet afat - shkurtra.
 - B. Koeficienti i pasurive qarkulluese plus stoqet mbi detyrimet afat - shkurtra.
 - C. Koeficienti i pasurive qarkulluese minus stoqet mbi detyrimet afat - shkurtra.
 - D. Koeficienti i pasurive qarkulluese minus stoqet minus llogaritë e arketueshme mbi detyrimet afat - shkurtra.

(2 pikë)

6. Sasia e Porosisë Ekonomike (SPE) është(1):
- A. Sasia që duhet të porositet për të minimizuar koston e blerjes së një artikulli të stoqeve
 - B. Sasia që duhet të shitet për të minimizuar koston e shitjes së një artikulli të stoqeve
 - C. Sasia që duhet të porositet për të zvogeluar stoqet e një kompanie në depo
 - D. Sasia që duhet të porositet për të rritur stoqet e një kompanie në depo
- (2 pikë)
7. Cilët prej elementeve të mëposhtme duhet të përfshihen në parashikimin e rrjedhjeve të parasë së gatshme gjatë planifikimit financiar (3)?
- A. Fondet prej emetimit të kapitalit të ri aksionar
 - B. Rivlerësimi i një pasurie jo – qarkulluese
 - C. Arkëtimet e dividendëve prej bizneseve të tjera
 - D. Zhvlerësimi i makinerive të prodhimit
 - E. Fshirja nga librat e borxheve të këqija
 - F. Shlyerja e i një kredie bankare
- (2 pikë)
8. Metodatat për vlerësimin e projekteve kapitale të cilat përdorin rrjedhat e skontuara të parasë janë:
- A. Metoda e vlerësimit të tanishmeve neto
 - B. Periudha e shlyerjes në vite
 - C. Kthimi prej kapitalit të përdorur
 - D. Metoda e normës së brendshme të kthimit
- (2 pikë)
9. Bazuar në metodën e vlerësimit të investimeve kapitale, Neto Vlerësimit të Tanishme (NVT), një projekt pranohet nëse(1):
- A. NVT e projektit është e barabartë me 0 (zero)
 - B. NVT e projektit është pozitive
 - C. NVT e projektit është negative
 - D. NVT e projektit është e balancuar
- (2 pikë)
10. Kompania “Texas” LLC pret që hyrjet në bankë prej një investimi të jenë 50,000 euro pas 2 viteve. Nëse norma e kthimit/skontimit është 10%, llogaritni vlerën e tanishme të këtyre mjeteve?

$$\text{Vlera e tanishme (VT)} = \frac{\text{Vlera e ardhme (VA)}}{(1+r)^n} =$$

$$VT = 50,000 / (1+0.10)^2 = 41,322.31 \text{ euro}$$

(2 pikë)

11. Kërkesa për një artikull është 4,000 njësi në vit, dhe është pak a shumë e njëjtë gjatë gjithë vitit. Dhënia e një porosie [mandat – pagese] kushton €20, dhe mbajtja e një njësie për një vit kushton 0.50 euro. Sa është madhësinë e porosisë e cila minimizon kostot e stoqeve (SPE)?

$$SPE = \sqrt{\frac{2CD}{Ch}} =$$

$$SPE = \sqrt{\frac{2 \times 20 \times 4000}{0.5}} = 565.68$$

(2 pikë)

12. Bazuar ne informatat perkatese te projekteve kapitale me poshte te gjendet periudha e shlyerjes/kthimit ne vite per secilin projekt?

	Projekti A	Projekti B
Investimi kapital	60,000	60,000
Fitimet para zhvlerësimit		
Viti 1	15,000	30,000
Viti 2	20,000	25,000
Viti 3	25,000	10,000
Viti 4	30,000	10,000
Viti 5	35,000	10,000

Periudha e kthimit (Projekti A): 3 vite

Periudha e kthimit (Projekti B): 2.5 vite

(3 pike)

1. Auditorët mund të eliminojnë rrezikun e anagzimit :

A. Në asnjë rrethanë

- B. Duke përcaktuar politika për pranimin dhe vazhdimin e angazhimit me klientët.
- C. Duke e zvogëluar rrezikun e auditimit.
- D. Duke zvogëluar materialitetin.

(1 pikë)

2. Elementi i procesit të planifikimit të auditimit që ka mundësi të madhe të dakordohet me klientin para implementimit të strategjisë së auditimit është përcaktimi i :

A. Kohës së kryerjes së procedurave të vëzhgimit të stoqeve.

- B. Dëshmime që duhet të mbledhen për të ofruar bazë të mjaftueshme për opinionin e auditorit.
- C. Procedurave që do të ndërmerren për të zbuluar çështjet ligjore, kërkesat dhe vlerësimet ligjore.
- D. Çështjet ligjore të mbetura pezull që duhet të përfshihen në pyetjet për avokatin e klientit.

(1 pikë)

3. Auditori ka ardhur në konkludim se nuk ka pasur ngarkesë të tepërt në koston e stoqeve të kostos së kohës kur makinat nuk janë përdorur në prodhim. Ky konkludim ka mundësi të madhe të ketë të bëjë me objektivën e auditorit për të përfutur dëshmi për pohimet e stoqeve sa i përket prezentimit dhe shpalosjes dhe :

A. Vlerësimin dhe alokimit.

- B. Plotësisë.
- C. Ekzistencës.
- D. Të drejtave dhe obligimeve.

(2 pikë)

4. Gjatë auditimit të një ndërmarrje të mesme prodhuese, cila nga fushat në vijim pritet të merr më së paku kohë të auditimit?

A. Fitimet e mbajtura.

- B. Të hyrat.
- C. Pasuritë.
- D. Detyrimet.

(1 pikë)

5. Cila nga rastet në vijim nuk është procedurë tipike e rishikimit analitik?
- A. Studimi i marrëdhënjeve të informatave financiare me informatat përkatëse jofinanciare.
 - B. Krahasimi i informatave financiare me informatat e ngjashme sa i përket industrisë në të cilën operon entiteti.
 - C. Krahasimi i shumave të regjistruara të pagesave kryesore me faturat përkatëse.**
 - D. Krahasimi i informatave financiare me shumat e buxhetuara.
- (1 pikë)
6. Kapitalizimi i lizingut më së miri përshkruhet me cilën nga pohimet e mëposhtme të saldoeve të llogarive?
- A. Ekzistenca ose ndodhja.
 - B. Plotësia.
 - C. Të drejtat dhe obligimet.**
 - D. Prezentimi dhe shpalosja.
- (1 pikë)
7. Testet e pavarura për të ekzaminuar pohimin e plotësisë për llogaritë e pagueshme përfshijnë:
- A. Testimin e një mostre të urdhërpagesave për urdhërblertet e autorizuara
 - B. Gjurmimi i një mostre të urdhërpagesave deri te ditari i blertjeve.**
 - C. Krahasimi i datave në urdhërpagesa me datat në ditarin e blertjeve.
 - D. Rillogaritja e saktësisë matematikore e një mostre të faturave të furnitorëve.
- (2 pikë)
8. Një kontroll që siguron se huaja afatgjatë është inicuar në mënyrë të duhur nga individët e duhur adreson pohimin e :
- A. Ndodhjes.
 - B. Autorizimit.
 - C. Plotësisë.
 - D. Vlerësimit.**
- (2 pikë)
9. Cila nga llogaritë në vijim ka mundësi të madhe të rishikohet nga auditori për të përfutur siguri të arsyeshme se shtesat/ blertjet në llogarinë e pajisjeve nuk janë nënvlerësuar?
- A. Shpenzimet e riparimit dhe mirëmbajtjes.**
 - B. Shpenzimet e zhvlerësimit.
 - C. Fitimi nga shitja e pajisjeve.
 - D. Llogaritë e pagueshme.
- (1 pikë)

10. Auditori i cili e pranon angazhimin dhe nuk posedon ekspertizë në industrinë e biznesit të entitetit, duhet:
- A. Të angazhoj ekspert financiar që janë të njohur me natyrën e biznesit të entitetit.
 - B. Të përftoj njohuri për çështjet që kanë të bëjnë me natyrën e biznesit të entitetit.**
 - C. T'ia referoj një pjesë të madhe të auditimit një auditori tjetër, i cili do të veproj si auditor kryesor.
 - D. Së pari të informoj menaxhmentin se nuk mund të jap opinion pa rezervë.
- (2 pikë)
11. Pas përfundimit të fazës paraprake të rishikimit të kontrolleve të brendshme të kontabilitetit, auditori vendos mos të mbështetet në atë sistem për të kufizuar testet e pavarura. Dokumentimi mund të jetë i limituar vetëm për :
- A. Të kuptuarit e auditorit për sistemin e kontrollit të brendshëm.**
 - B. Arsyet e auditorit pse ka vendosur mos të vazhdoj rishikimin.
 - C. Bazën për konkludimin e auditorit se gabimet dhe mashtrimet do të parandalohen.
 - D. Ta plotësuar pyetësonin e kontrollit të brendshëm nga auditori.
- (2 pikë)
12. Për të grumbulluar dëshmi sa i përket saldosh sipas bankës në harmonizimin bankar, auditori do të ekzaminonte të gjitha përveç:
- A. Prerjes së raportit bankar.
 - B. Raportin bankar të fundit të vitit.
 - C. Konfirmimin bankar.
 - D. Librin kryesor.**
- (1 pikë)
13. Auditori i pavarur zbulon se korporata Hold shfrytëzon lokalet për zyra në ndërtesën që është pronë e një aksionari të asaj korporate. Kjo gjetje është tregues i ekzistencës së:
- A. Mashtrimit nga menaxhmenti.
 - B. Transaksioneve në mes të palëve të ndërlidhura.**
 - C. Zbukurimit të pasqyrave financiare.
 - D. Kontrollit të brendshëm të dobët.
- (1 pikë)
14. Auditori në përgjithësi teston sigurinë fizike mbi stoqet përmes:
- A. Numërimeve testuese dhe procedurave të prerjes.
 - B. Ekzaminimit dhe harmonizimit.
 - C. Inspektimit dhe rillogaritjes.
 - D. Bisedave dhe vëzhgimit.**
- (1 pikë)

15. Auditori ka përfshirë një paragraf të veçantë në një raport i cili përndryshe është i pamodifikuar për të theksuar se enteti për të cilin po raportohet ka pasur numër të konsiderueshëm të trasaksioneve në mes të palëve të ndërlidhura. Përfshirja e këtij paragrafi të veçantë:

- A. Konsiderohet rezervim/kualifikim “përveç për” i opinionit.
- B. Shkel standardet e auditimit nëse kjo informatë tashmë është shpalosur në shënimet e pasqyrave financiare.
- C. Paraqet nevojën për rishikimin e paragrafit të opinionit për të përfshirë frazën “me shpjegimin pasues”.
- D. Është i përshtatshëm dhe nuk do të kundërshtonte opinionin pa rezervë.**

(2 pikë)

16. Cila nga deklaratat në vijim është e saktë sa i përket mostrimit statistikor gjatë testimit të pajtueshmërisë?

- A. Madhësia e popullatës ka pak ose fare nuk ka efekt në përcaktimin e madhësisë së mostrës përveç për popullata shumë të vogla.**
- B. Norma e pritur e normës së devijimit në popullatë ka pak ose nuk ka fare efekt në përcaktimin e madhësisë së mostrës përveç për popullata shumë të vogla.
- C. Me dyfishimin e madhësisë së popullatës, poashtu edhe madhësia e mostrës duhet të dyfishohet.
- D. Për normën e dhënë të devijimit të tolerueshëm, duhet të përzgjedhet një mostër më e madhe pasi që norma e pritur e devijimit zvogëlohet.

(2 pikë)

17. Auditori e zbulon një mashtrim të mundshëm gjatë auditimit por vjen në përfundim se efekti i mashtrimit nuk është material për të ndikuar në opinionin e auditimit. Auditori duhet të:

- A. Shpalos mashtrimin në nivelin e përshtatshëm të menaxhmentit të klientit.**
- B. Shpalos mashtrimin autoriteteve të përshtatshme jasht klientit.
- C. Diskutoj me klientin procedurat shtesë që janë të nevojshme në identifikimin e shumës së saktë të mashtrimit.
- D. Modifikoj programin e auditimit për të përfshirë testet që në mënyrë specifike janë të disenjuara të identifikojnë mashtrimin dhe ndikimin e tij në pasqyrat financiare.

(1 pikë)

18. Cilën nga rastet në vijim ka mundësi të madhe ta përdor auditori në planifikimin e materialitetit?

- A. Madhësinë e parashikuar të mostrës për testet e pavarura të planifikuara.
- B. Pasqyrat financiare të ndërmejtme duke i planifikuar si pasqyra vjetore.**
- C. Rezultatet e pyetësorit të kontrollit të brendshëm.
- D. Përmbajtjen e letrës së përfaqësimit të menaxhmentit.

(1 pikë)